



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/78 Nr. i faq/Br.str/No.pg 81

Data/Datum/Date 8 / 12 / 2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017 dhe nenit 8 të Rregullores së punës të Kuvendit Komunal të Rahovecit me nr. prot. 01 Nr. 693, e datës 15 maj 2009, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 8.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit

1. Me këtë vendim, z. Fatmir Iska nga Rahoveci, **ZGJIDHET** kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit.
2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit zgjidhet për mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës 29.3.2017 dhe Rregulloren e Punës të Kuvendit Komunal të Rahovecit me nr. prot. 01 Nr. 693, të datës 15 maj 2009.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Sekretarisë së Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.76/25
Datë: 8.12.2025



Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit